



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e XLVIII-të (dyzetetë) - e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 29 janar 2025.

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Xhevdet Maloku; Haki Rudari; Bahri Blakçori; kurse munguan; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Ardi Hasani; Lirika Maliqi.

Nga LDK, Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Qendresa Haliti; Fatmir Gashi, kurse munguan; Valon Demolli; Ilir Koprani;

Nga PDK, Bashkim Syla; Mimoza Abdullahu, kurse mungoi Endritë Murati.

Nga AAK, Burim Hasani; Arbnor Fazliu, kurse mungoi Mrika Thaçi

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Demokrat Hodolli., kurse mungoi Adnan Zymeri,

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkryetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Valbona Azemi-Drejtorja e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Liridon Gashi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Vlora Jashanica-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR)

Të pranishëm ishin edhe, Kovacs Karoly përfaqësues i KFOR-LMT; Samir Calakovic Caleb Waugh përfaqësues të OSBE, media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i'u dëshiruar të pranishmëve punë të mbarë, konstatoi kuorumin ku për momentin në fillimin e mbledhjes në sallë ishin 21 anëtarë/e të Kuvendit kurse mungonin 14, theksoi, pasi kushtet janë krijuar për fillimin e mbledhjes po vazhdojmë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

z.Liridon Gashi, drejtor i DPUMM, theksoi, meqë është adresimi im i parë dhe njëkohësisht mbledhja e parë e Kuvendit për vitin 2025, ju uroj të gjithëve punë të mbarë dhe suksese në angazhimet e juaja si dhe angazhimet e juaja në vazhdimësinë e punës me realizmin e të gjitha kërkesave, planeve dhe rezultate të mira për këtë vit.

Është kënaqësi për mua t'ju drejtohem prej pozitës së re e cila ndonëse i vetëdijshëm që është pozitë politike por megjithatë vizioni dhe qëllimi është krejtësisht teknik me qytetarin në qendër me qëllim të përmirësimit të gjendjes, kualitetit dhe cilësisë së jetës së qytetarit.

Tek pjesa ime për sot është ndryshimi i rendit të ditës për pikën e propozuar që është anulimi i vendimit për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm pjesa e poshtë qendër lindje 2-blloku 1, kjo për shkak të angazhimeve dhe prenotimit të takimeve me Ministrinë e linjës shumë kohë më parë, me mirëkuptimin tuaj do të kërkoja që kjo pikë e rendit të ditës të renditet pikë e parë e rendit të ditës në këtë mbledhje, kjo me qëllim të trajtimit të kërkesës ndonëse kërkesa është shumë e thjeshtë shumë e lehtë dhe kërkojmë votën tuaj, mirëpo nëse eventualisht kërkohet debat apo sqarime të tjera jam i gatshëm që me mirëkuptimin tuaj do të dëshiroja që kjo të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, derisa po debatojmë për rendin e ditës për këtë seancë dhe kemi një propozim që edhe dje erdhi në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa-KPF si propozim vendim për shfuqizimin e një vendimi të marrë më parë nga ky Kuvend, kurse sot doli edhe propozimi i dytë që ajo pikë të vëhet si pikë e parë e rendit të ditës e që nuk do të thotë se është diçka që nuk duhet të përkrahet pas arsytimit të drejtorit parafolës që ishin shkak i angazhimeve të tij kjo pikë të kalojë pikë e parë e rendit të ditës.

Po kthehem te çështja e parë, ky propozim vendim për shfuqizimin e një vendimi të mëparshëm, edhe dje po edhe sot e cilësojmë si jo të përgatitur të jetë pjesë e debatit gjegjësisht nuk i ka përfillur procedurat për vendimmarrje në Kuvendin e Komunës ngase me vet faktin e formës se si i është drejtuar Kuvendit është një formë, një precedent dhe një diçka që nuk duhet të ndodh në praktikën e propozim vendimeve në Kuvendin e Komunës dhe këtë po e ndaj me ju kolegë.

Dje në mbledhjen e KPF-së po edhe sot para vetës ju anëtar/e të Kuvendit besoj nuk e keni as këtë që drejtori i DPUMM, për shfuqizimin e një vendimi e ka paraqitur një kërkesë te Kryesuesi i Kuvendit për futjen në rend të ditës në mbledhjen e datës 29.01.2025, pra kërkesë, ndërsa ne si Kuvend do të duhej ta kishim prej kërkesës së i është pranuar drejtorit të cekur që të futet në rend të ditës, para neve do të duhej të ishte një propozim vendim për shfuqizimin e vendimit, por ne tani kemi vetëm një kërkesë për shfuqizimin e atij vendimi. Si do që të jetë ai vendim të cilin e kemi marrë ne në këtë Kuvend ka hasë në të metat e tij i cili e ka bërë të pa aplikueshëm për tu zhvilluar procedurat tutje dhe kish dashtë që vërtetë ata që hartojnë propozime dhe vendime të jenë më të vëmendshëm dhe të mos na qesin në këso situata që të marrim vendime që janë në kundërshtim me rregullativën ligjore në nivel Kosove e që kjo nuk është hera e parë që na ndodh sepse po na ndodhin shumë shpesh, por si do që të jetë deri sa nuk kemi diçka konkrete dhe nuk kemi një propozim vendim por kemi vetëm një kërkesë dhe ajo e drejtuar te Kryesuesi i Kuvendit i cili dje në KPF na e ka shpërndarë neve anëtarëve të KPF-së, si e tillë nuk i përmbushë kriteret, standardet dhe praktikën për vendimmarrje.

E dyta që më bëri të marrë fjalën rreth rendit të ditës deri sa nuk është aprovuar rendi i ditës, në mbledhjen e kaluar siç jeni dëshmitar të gjithë ju, kemi pas një propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të komisioneve të aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.a. në Podujevë, dhe çka ka ndodh, kur kjo pikë ka ardh në rendin e ditës, mbledhja gjegjësisht Kuvendi ka mbete pa kuorum dhe është ndërprerë mbledhja, tani a kemi pasë përfundim të asaj mbledhje, nëse kemi pas përfundim të asaj mbledhje, sot e kemi të njëjtën pikë të rendit të ditës dhe ajo pikë na përsëritet sërish nëpër procedura qoftë të KPF-së qoftë edhe të Kuvendit, dhe nuk ish dashtë të ndodh, edhe kjo është kundër çdo praktike dhe kundër çdo logjike si dhe kundër çdo normative që e rregullon këtë lëmi, sot kjo seancë kish dashtë të fillojë me vazhdimin e seancës tjetër, seancës së kaluar, dhe ajo pikë e rendit të ditës ku kërkohet vendimi i këtij Kuvendi kish dashtë që ky Kuvend ta kishte

marrë një vendim sot pasi sot ka kuorum ndërsa në mbledhjen e kaluar nuk ka pasë kuorum, dhe çka na ndodh, sot e njëjta pikë na përsëritet si pikë e tretë e rendit të ditës.

Që të dyja këto nuk kanë se si të cilësohen ndryshe, vetëm papërgjegjësi dhe parregullsi në punën e Kuvendit.

z.Bashkim Syla, theksoi, mendoj që si Kryesues i Kuvendit të Komunës por edhe Zyra ligjore, çdo vendim që nxjerrët nga Kuvendi i Komunës së Podujevës duhet të kalojë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për ligjshmërinë e atij vendimi, kështu që edhe nëse nuk ka pasë kërkesë prej drejtorit të Drejtorisë përkatëse, ka qenë obligim i Zyrës së Kryetarit dhe Zyrës ligjore që vendimet që nuk janë në përputhje me ligjin, të shfuqizohen në mënyrë që t'i hapet rrugë për iniciimin e vendimit tjetër që është në përputhje me ligjin.

Kështu që sa i përket këtij propozim vendimi mendoj se është në rregull, mirëpo mënyra që të dilet si pikë e parë e rendit të ditës atëherë ajo del në votim dhe e vlerësojnë vetë anëtarët e Kuvendit është në rregull si çështje që të del si pikë e rendit të ditës ose të vazhdohet si pikë e fundit e rendit të ditës ashtu siç është përcaktuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, e kam parë Planin e punës së Kuvendit i cili është aprovuar para rreth 1 muaj e gjysmë dhe për mbledhjen e muajit janar po mungojnë këto pika; -Plani punës së KKS-së për vitin 2025, -Plani i prokurimit për vitin 2025 pra raport nga Drejtoria e Administratës e që po e kursejmë drejtoreshën e Administratës meqë është në fillim të marrjes së kësaj detyre mirëpo prapë prapë në rend të ditës është dashtë të jetë kjo pikë, dhe arsyetimin për mos përgatitjen e kësaj për shkak të periudhës së shkurtër të emërimit të saj është dashtë ta arsyetoj sot, pastaj mungon ajo që këtu thuhet raportimet e komisioneve të Ndërmarrjeve Publike kurse ne kemi vetëm një raportim nga një Ndërmarrje Publike dhe po ashtu mungon informata për gjendjen e sigurisë në Komunën e Podujevës nga Policia e që unë nuk e di dhe do të ishte mirë të na sqarohet se a është bërë ndonjë thirrje apo jo.

z.Haki Rudari, theksoi, ne dje kemi pas një mbledhje të KPF-së dhe ajo mbledhje ka përfunduar me disa rekomandime të cilat janë sjellë sot në seancë të Kuvendit dhe unë besoj që shërbimi profesional apo Zyra ligjore ato rekomandime ju ka dërguar secilit asambleistë për arsye se nuk jemi të gjithë anëtarë të KPF-së, e para.

E dyta, Rregullorja e punës së Kuvendit e thotë që Kuvendi vendos veç e veç për çdo propozim për plotësim apo ndryshim të çështjes ose të rendit të ditës, prandaj ishte një kërkesë e drejtorit të DPUMM dhe që ne rekomandimet i kemi marrë dhe tani a e ka ndokush kopje fizike apo vetëm në e-mail kjo është diçka tjetër. Pra në KPF ishte kërkesë e drejtorit të DPUMM për futjen në rend të ditës pikën në fjalë dhe në KPF ka kaluar ajo kërkesë, kurse tani kemi rekomandimet, andaj kërkesa e drejtorit në fjalë ishte që pika në fjalë e rendit të ditës të votohet në Kuvend dhe e njëjta të renditet si pikë e parë e rendit të ditës dhe Kryesuesi i Kuvendit do të duhej ta hedhtë propozimin në votim, nëse nuk kalon jemi në rregull, ne këtu nuk kemi ardhur të "kukatim", por nëse kalon atëherë pikë e parë e rendit të ditës mbetet kjo pikë dhe vazhdohet tutje, prandaj është mirë që këto çështje të respektohen nga të gjithë për arsye se kjo Rregullore e punës së Kuvendit të cilës ne i referohemi vazhdimisht, e kam thënë dhen po e përsërisë, është e obligueshme për të gjithë, madje nganjëherë as neve nuk na bie mirë por duhet të pajtohemi, nganjëherë dikujt tjetër, prandaj kështu e thotë Rregullorja në fjalë.

Kërkesa nga Ministria është për futje në rend të ditës vendimi i iniciimit të procedurave, pra ka të bëjë për anulimin e vendimit në fjalë, nuk ka të bëjë me ndonjë plotësim ndryshim.

Edhe në mbledhjen e Grupit të LVV-së që kishim sot unë e pyeta drejtorin e DPUMM i cili më sqaroi se nuk ka të bëjë me kurrfarë propozimesh tjera por në këtë seancë ka të bëjë vetëm me anulimin e vendimit për iniciimin e procedurave kurse në një prej seancave të radhës mund të vijë

propozim për diçka tjetër dhe atëherë ne jemi këtu të nderuar kolegë anëtarë të kuvendit dhe e analizojmë dhe votojmë e që fundja secili e ka votimin e tij qoftë personal qoftë në emër të Grupit që i takon.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, këtu kemi të bëjmë vetëm me deklaratimet se a të hyhet në rend të ditës kjo pikë e rendit të ditës apo jo, andaj e hedh në votim kush jeni që kjo pikë e rendit të ditës të hyjë apo jo në rend të ditës dhe të renditet pikë e parë e rendit të ditës, pastaj nëse hyn mund të debatojmë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 24 anëtarë/e të Kuvendit sa i shin prezent në sallë, me 13 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan) mbështetet propozimi / kërkesa e drejtorit të DPUMM që pika e rekomanduar nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa si pikë e 6 e rendit të ditës; Anulimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 datë 31.07.2024 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1, të shqyrtohet si pikë e parë e rendit të ditës në këtë mbledhje.

Pra mbështetet të përfshihet pikë shtesë në rendin e ditës të kësaj mbledhje duke e renditur si pikë e parë, dhe atë sipas materialit përkatës të prezantuar në mbledhjen e KPF-së si dhe të përcjellë anëtarëve të Kuvendit së bashku me konstatimet e rekomanduara.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa i përket pyetjeve të z.Xhevdet Malokut lidhur me raportimet e drejtorëve të Drejtorive për çka mund të them se nuk i kanë sjellë ato raporte dhe nuk janë përfshirë në rend të ditës, ndërsa sa i përket raportimit të Policisë, unë e kam kontaktuar Komandantin e Policisë dhe ai më ka thënë që procedurat janë kështu duke kërkuar që t'ia dërgojmë një kërkesë me e-mail, që ajo kërkesë pastaj të përcjellët prej tyre në institucionet më të larta se kur mund të raportoj para Kuvendit të Komunës, kështu që ne i'a kemi përcjellë përmes e-mailit atë kërkesë por që ende nuk kemi marrë përgjigje. Pra kurdo që ai është i gatshëm të raportoj në Kuvend ne do ta ftojme, kjo ishte arsyeja.

z.Arjant Topanica, theksoi, përtej kësaj që u tha, unë nuk do e zgjasë shumë ngase do të doja një diskutim me Kryetarin e Komunës për shkak që të ngris një shqetësim rreth gjuhës së ulët që kishte përdorur në mbledhjen e kaluar, mirëpo meqë ai nuk është këtu sot, por që kishte fol kur unë nuk kam qenë këtu prezent, po e pres kur është këtu.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i reaguar kërkon që herëve tjera të qëndroj në mbledhje.

z.Arjant Topanica, duke i'u përgjigjur Kryesuesit, theksoi, nuk mund të ma përcaktosh ti Kryesues a qëndroj apo jo sepse jemi njerëz dhe nganjëherë kemi ndonjë urgjencë dhe nuk mund ta dish ti, andaj për këtë arsye nuk ka nevojë të konstatosh ti diçka të tillë.

Kryesuesi i Kuvendit, sërish i reagon parafolësit, thekson, shpesh herë ti po ke urgjenca dhe ke shumë mungesa dhe këtë ta them publikisht.

z.Arjant Topanica, sërish duke i'u përgjigjur Kryesuesit, theksoi, është shumë e pavërtetë ajo që e ceke Kryesues, përndryshe a mund të thirresh zyrën ligjore dhe t'i numërosh mungesat e mia dhe t'i thuash publikisht këtu, madje edhe mungesat e të gjithëve potencoj këtu publikisht.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, në mbledhjen e radhës do e bëjë atë.

z.Arjant Topanica, theksoi, po ashtu ti Kryesues është mirë të kërkojë falje për atë që e ceke sepse nuk është konstatim i drejtë. Përndryshe në 4 vite mandat mund të ketë çdonjëri mungesa, por të thuhet ke shumë mungesa...., kurse tjetër është të thuash ke 1 apo 2 mungesa e që nuk janë shumë.

Kryesuesi i Kuvendit, sërish përgjigje parafolësit, theksoi, unë nuk përmenda numra të mungesave por vetëm e ceka se ke mungesa, ndërsa në mbledhjen e radhës i shikojmë vetëm ato të vitit 2024.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë kërkoja të na sqarohet pse duhet të jetë pika e pestë e rendit të ditës sot në këtë mbledhje, që është pikë e një seance të ndërprerë, nuk mu dha sqarim nga ti Kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, ashtu e kemi radhitur dhe nuk i kemi kushtuar rëndësi asaj çështje por e kemi vendos në këtë rend të ditës duke e vendosur në pikën e pestë.

z.Naim Çunaku, nga vendi, theksoi, ku e ke bazuar që e ke bërë atë zotëri Kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, seancën e kaluar e kam shpall të mbyllur.

E hedh në votim rendin e ditës sipas thirrjes, konstatimeve të rekomanduara nga KPF, si dhe konstatimit të mbështetur paraprakisht sa i përket rendit të ditës dhe renditjes së pikave.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 24 anëtarë/e të Kuvendit sa i shin prezent në sallë, me 14 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, përfshirë edhe pikën shtesë të rekomanduar nga KPF si dhe të mbështetur në fillim të kësaj mbledhje që ishte Anulimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 datë 31.07.2024 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1.

Rendi i miratua i ditës:

1. Anulimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 datë 31.07.2024 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1
2. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike
3. Draft Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban i Komunës së Podujevës për vitet 2025-2029
4. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024
5. Raporti vjetor për vitin 2024 i Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë
6. Propozim vendimi për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.A. Podujevë; *NPL Stacioni i Autobusëve, NPL për Banim, NPL “Eko-Llapi” (pikë nga mbledhja e kaluar e Kuvendit)*
7. Të Ndryshme

1. Anulimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 datë 31.07.2024 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1

z.Liridon Gashi, drejtor i DPUMM, duke e paraqitur fjalën hyrëse, theksoi, fillimisht ju falënderoj të gjithëve për përkrahje në realizmin e kërkesës time rreth rendit të ditës.

Sa i përket kërkesës për vendim për anulimin e vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1, kronologjikisht ju e them s ky vendim është marrë më 31.07.2024, pastaj siç e përcakton legjislacioni në fuqi duhet që të marrë aprovimin apo miratimin e ligjshmërisë në institucionet përkatëse, pra kronologjikisht vetëm se është në kërkesë, ndërsa shkresa e fundit prej Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është me disa rekomandime dhe disa të gjetura me shkelje të dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ 01/2018 për formën e hartimit, zbatimit dhe monitorimit të Planeve Rregulluese të Hollësishme, dhe ne si Drejtori duke pas parasysh devijimet prej Udhëzimit Administrativ të cekur apo mos përputhjes së vendimit kemi konsideruar që rruga më e shpejtë për realizmin apo iniciimin e ri të planit në fjalë është anulimi i atij vendimi dhe fillimi i procedurave të reja për hartimin e Planit në fjalë i cili do të ishte edhe në kontekst më i gjerë hapësinor në përputhje të plotë me dokumentin e planifikimit hapësinor gjegjësisht Hartës Zonale komunale e miratuar vetëm dy vite më parë, andaj sërish kërkoj nga ju që të votoni për kalimin e anulimit të vendimit për të cilin veç po flasim.

z.Haki Rudari, theksoi, unë e potencova edhe pak më parë dhe po e them tani edhe njëherë se Grupi i këshilltarëve të LVV-ës e përkrahë dhe do të voton Pro kërkesën për anulimin e vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1. E them këtë duke u bazuar edhe në këtë për arsye se vendimet të cilat i merr Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal-MAPL janë vendime të obligueshme për të gjitha Kuvendet komunale, dhe natyrisht se Komunitat nuk mund të dalin kundër MAPL-së.

Ka pas edhe kërkesa tonat që nuk na kanë pëlqyer, prandaj duhet të mësohemi dhe të respektojmë vendimet që janë ligjore dhe që vijnë nga MAPL e që natyrisht se ne i përkrahim dhe do të votojmë për shqyrtimin e tyre, fundja ne jemi për një plan të detajuar duke u bazuar në të gjitha planet që janë miratuar në Kuvendin e Komunës tonë kështu që ne në këtë formë do të shkojmë edhe më tutje, pra do të votojmë Për kërkesës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës në mënyrë që t'i hapet rrugë për të ardhmen që të sjellët në seancën e radhës sigurisht një propozim konform ligjit ose MAPL-së.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me propozimin si pikë shtesë të rendit të ditës që e patëm edhe njëherë po e potencoj se kur isha pak më parë në foltore nuk i kisha dokumentet me vete kurse tani këtu i kam dy dokumentet që na janë sjellë si material neve anëtarëve të Kuvendit të Komunës. Në këtë formë, pa hy në atë që kolegët tanë deshtën të na bindin thuajse ne jemi për herë të parë këtu dhe nuk i dim procedurat e vendimmarrjes së këtij Kuvendi dhe procedurat të cilat duhet t'i kaloj një vendim për të qen i plotfuqishëm. E di që të gjithë ne këtu që kontroll i vendimmarrjes të Kuvendeve komunale është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe këtu nuk kemi asnjë dilemë dhe asnjë kontest nuk kishim, pastaj nuk është hera e parë që na kthehen vendime dhe as këtu nuk kemi asnjë kontest, mirëpo kontesti ishte forma si është proceduar kjo pikë e rendit të ditës. Ne ose asnjë nga ne, ose të ndarë vetëm ne si grupim, nuk kemi përfillje të proceduarve dhe praktikave se si shfuqizohet një vendim, një fletë e formatit A4 ka qenë dashtë të jetë propozim për shfuqizimin e vendimit në fjalë, a e kemi atë fletë, jo.

Na është plotësuar duke na u thënë që e kemi një kërkesë, çfarë kërkesë është, ne a marrim vendim për kërkesa, prandaj kjo na bëri që ta kontestojmë jo pse duhet dhe pse po tregojmë këmbëngulësi ne si Grupi që duhet ta shtyjë një vendim jo të ligjshëm, jo të zbatueshëm, të papunuar mirë, në kundërshtim me ligjin dhe që i ka harxhuar kohë këtij Kuvendi dhe kësaj Komune më tepër se me muaj, këtu e gjujkojmë këtë gjë, mirëpo forma që ejani të marrim një diçka në kundërshtim me praktikën, procedurat dhe ligjshmërinë, mos provoni të na e thoni këtë, kjo ishte para.

E dyta, asnjë sqarim nuk mora si ka ndodh me pikën e pestë të rendit të ditës të mbledhjes së kaluar, një pikë e rendit të ditës e cila nuk ka marrë epilog të këtij Kuvendi ajo duhet të jetë vazhdim, e vazhdimi është para se të filloj seanca e re, asnjë sqarim nga Kryesuesi.

Dhe më e keqja është se deri sa ne debatojmë, dikush nga vendi na thotë, ju keni ikë, po kush ka ikë dhe pse kemi nevojë ne të ikim, jo more ne nuk kemi ikë por ne jemi këtu por nuk jemi këtu për t'ju bashkëngjitur një shkelje ligjore dikujt tjetër, jemi këtu në rolin tonë opozitar që ta bëjmë opozitën çfarë na takon ta bëjmë dhe si rezultat i kësaj seance, i mos përgatitjes së kësaj seance si dhe këtyre shkeljeve, ne edhe sot dhe e thërras Grupin e këshilltarëve të LDK-së ta liroj sallën, ndërsa le të vazhdojnë këta me shkeljet e tyre, mirëpo nuk po ikim por po dalim burrërisht sepse nuk dëshirojmë të jemi pjesëmarrës në shkeljet ligjore.

(Grupi i LDK-së, lëshon sallën me arsyetimin e thënë nga parafolësi paraprakisht).

Kryesuesi i Kuvendit, kërkon nga znj. Donjetë Sheqiri që të mos nënshkruhet në listën e nënshkrimeve të pjesëmarrjes në mbledhje meqë posa hyre në sallë dhe nuk është mirë vetëm të nënshkruhesh dhe të dalësh menjëherë.

znj. Donjetë Sheqiri, duke i reaguar Kryesuesit thekson që nuk e drejtë kjo çfarë thua, çka nëse unë nënshkruhem dhe qëndroj në sallë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pas krijimit të kësaj situatë, shkojmë në pauzë të shkurtër rreth 15-20 minuta, për tu kthyer në vazhdimin e mbledhjes në ora 11:00

Në mungesë të kuorumit, dhe në propozim të Kryesuesit të Kuvendit, jepet pauzë e shkurtër rreth 15-20 minuta.

(Pauza vazhdon për rreth 1 orë derisa anëtarët/et e Kuvendit të Komunës kthehen në sallë për të vazhduar me mbledhjen)

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi në ora 12:00. Prezent ishin:

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani Haki Rudari; Bahri Blakçori.

Nga LDK, Valon Demolli; Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; Fatmir Gashi.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu.

Nga AAK, Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Të pavarur, Demokrat Hodolli; Adnan Zymeri.

Po ashtu në vazhdimin e mbledhjes të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, znj.Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës;

(Valbona Azemi-Drejtoria e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Liridon Gashi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtoria e pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Vlora Jashanica-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtës dhe Shpëtimit DSHPMSh)

Të pranishëm po ashtu ishin edhe, Kovacs Karoly përfaqësues i KFOR-LMT; Samir Calakovic Caleb Waugh përfaqësues të OSBE, media lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, mund të vazhdojmë me mbledhjen, për momentin në sallë janë 24 anëtar/e të Kuvendit të Komunës, pra kuorumi ekziston dhe vazhdojmë mbledhjen. **znj.Donjetë Sheqiri**, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, të lutem a mund ta shpjegosh para qytetarëve a paguhemi ne me mëditje apo me pagë fikse

Kryesuesi i Kuvendit, duke i'u përgjigjur parafolësës, theksoi, është e ditur ajo që paguhemi me pagë fikse.

z.Valon Demolli, nga vendi ndërhyne duke i reaguuar Kryesuesit të Kuvendit se çfarë ka të bëjë pra nënshkrimi në listë që para pauzës e potencove te rasti i koleges znj.Donjetë Sheqiri, sepse nënshkrimi është vetëm për evidentim të prezencës në sallë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nënshkrimi në listën e pjesëmarrjes është vetëm për prezencë në sallë.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, do të thotë ne si asambleistë paguhemi me pagë fikse, atëherë po e demantojmë drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili ka shpif publikisht me një postim në Facebook që ka thënë se ne paguhemi me mëditje

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, po ashtu është por veç edhe jeni të obliguar secili të merrni pjesë në mbledhje. Pra secili asambleistë është i obliguar të marr pjesë në mbledhje.

znj.Donjetë Sheqiri, duke replikuar, theksoi, do të thotë të marrë pjesë në seancë po, por jo për mëditje, ju faleminderit shumë i nderuar Kryesues për këtë sqarim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani vazhdojmë aty ku mbetëm te pika e parë e rendit të ditës që ishte propozimi për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1, për të cilin drejtori i Drejtorisë përkatëse i paraqiti sqarimet më parë si dhe u debatua mjaftë për këtë pikë besoj, andaj nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën e hedhim në votim që të miratohet propozimi për anulimin e vendimit në fjalë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 26 anëtarë/e të Kuvendit sa i shin prezent në sallë, me 16 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), merret vendim për Anulimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 datë 31.07.2024 për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësisëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1.

(Arsyeja e anulimit është për shkak se Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës fillimisht ndër të tjera ka vlerësuar se “përshkrimi i tekstit është konfuz dhe i paqartë nëse Plani në fjalë parashihet apo jo në dokumentet e planifikimit hapësinor, dhe se raporti i arsyeshmërisë duhet të punohet në bazë të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2018, si dhe duke kërkuar që vendimit t’i bashkëngjitet ekstrakti nga dokumenti i planifikimit hapësinor në fuqi ku parashihet hartimi i këtij Plani”.

Gjithashtu pas komunikimeve dhe kërkesës së Komunës për rivlerësim të aktit, Ministria e cekur ndër të tjera ka kërkuar që “vendimi në fjalë duhet të plotësohet në preambulë me nenet 5, 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.01/2018, vendimit t’i bashkëngjitet ekstrakti nga dokumenti i planifikimit hapësinor në fuqi, si dhe raporti i arsyeshmërisë të punohet sipas neneve 6 dhe 7 të këtij Udhëzimi Administrativ”.

Po ashtu Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Podujevës, me qëllim të inicimit të ri procedural merr përsipër përgatitjen e dokumentacionit dhe procedimin në Kuvendin e Komunës në një afat sa më të shkurtër të mundshëm dhe atë konform vlerësimeve dhe rekomandimeve të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe konsultimeve paraprake me këtë Ministri).

(në mes znj.Donjetë Sheqiri dhe drejtorit të DKA z.Avni Fteahu vazhdon debati rreth çështjes së nënshkrimit në listën e pjesëmarrjes në Kuvend dhe postimit në Facebook, diskutime të cilat bëhen nga vendet ku janë ulur në formën e debatit mes vete për çka pothuajse është e pamundur të nxjerrën fjalimet dhe të përfshihen në procesverbal).

2. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, para vetës keni një propozim vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin Çerdhes publike, pra me këtë vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e objektivit me destinim për Çerdhe Publike në Podujevë, si në vijim; në një hapësirë ku tani është Shkolla “Enver Maloku” përkatësisht ku ka qenë më herët ish Gjimnazi “Aleksandër Xhuvani” ku është e përcaktuar edhe zona kadastrale në këtë pjesë, planifikohet të bëhet ndërtimi i një Çerdhe në qytet, për të vazhduar edhe me Çerdhe tjera që janë të planifikuara në qytetin e Komunës së Podujevës, andaj nga ju pres përkrahje për këtë propozim vendim që është në interes i përgjithshëm të qytetarëve tanë.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim për vendosjen e lokacionit për ndërtimin e Çerdhes pasi që besojmë fuqishëm në projektet që janë në të mirë të qytetarëve e veçanërisht kur bëhet fjalë për përkujdesjen dhe zhvillimin e fëmijëve.

Megjithatë dëshiroj të ngrisë disa pyetje dhe çështje për të cilat dua diskutim; sa i përket lokacionit si është përcaktuar ky lokacion dhe a është bërë ndonjë diskutim publik apo a është diskutuar me qytetarët e atij lokaliteti, sa jam në dijeni unë ky lokacion gjendet brenda oborrit të Shkollës “Enver Maloku” andaj a është shqyrtuar nëse ky lokacion mund të krijoj probleme pasi që fëmijët e Çerdhes dhe nxënësit e shkollës do ta shfrytëzojnë të njëjtën hapësirë të jashtme, dhe gjithashtu mbarëvajtja e mësimit gjatë periudhës së ndërtimit të kësaj Çerdhe.

Një shqetësim tjetër që dua ta ngrisë është sepse afër këtij lokacioni ndodhet një trafo elektrike nëse nuk jam gabim, andaj a është marrë parasysh ky fakt dhe a mund të ketë probleme, dhe sa i përket kësaj si është menduar të menaxhohet kjo situatë dhe a mund të paraqet rrezik për të ardhmen.

Po ashtu edhe si banore e atij lokaliteti e përkrahi dhe e mbështes këtë iniciativë mirëpo dëshiroj që pyetjet dhe shqetësimet e mia të marrin përgjigje në mënyrë që kjo iniciativë të ketë sukses.

z.Bashkim Sylja, theksoi, dola në foltore për shkak të një reagimi të shkurtër në lidhje me një status të postuar nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe ashtu siç jeni në dijeni edhe ju të gjithë që çdo propozim vendim që është marrë në të mirë të qytetarëve PDK ka qenë në seancë dhe si unike si dhe shumë herë madje duke e mundësuar edhe kuorumin për vazhdimin e seancave, kështu që edhe nuk është burrëri që të merr lavde vetëm LVV që po i shtyn përpara projektet e mëdha që janë në të mirë të qytetarëve, kurse në një formë t'i fajësoj të tjerët.

Asnjëherë në asnjë vendim që ka qenë në të mirë të qytetit, ne edhe kemi marrë pjesë edhe në debat dhe në votim pa asnjë kalkulim politik, kështu që e vetmja arsye ka qenë interesi i qytetarëve, andaj mendoj që të paktën duhet të jetë korrekt kur bëhen konstatime, kështu që edhe ne jemi për ndërtimin e Çerdhes dhe do të votojmë Pro këtij propozim vendimi.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së veç se foli parafolësja kolege, mirëpo është mirë që kur të qitësh status për burrëri njeri më i pa burrë në Komunën e Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, duke i reaguuar parafolësit, theksoi, nuk është foltorja për tu përdorur për këto gjëra dhe kjo vlen për secilin.

z.Naim Çunaku, theksoi, pas zhvillimeve të reja që ndodhën dhe pas asaj që e shfaqën kolegët anëtar të Kuvendit të Komunës, e ndjejë obligim njerëzor si në kuptimin personal ashtu edhe në kuptimin e subjektit që i përkas që edhe ne në asnjë moment asgjë që ka ardhë në këtë Kuvend për lehtësimin, përmirësimin, avancimin e të mirës qytetare kurrë Lidhja Demokratike e Kosovës me asnjë veprim nuk ka qenë kundër, madje me vet faktin që edhe kjo pikë kur erdhi në rend të ditës dhe e nderuara kolege znj.Arnisa Sylejmani qysh n fillim por edhe dje në mbledhjen e KPF-së e kemi përkrahë edhe këtë propozim vendim, dhe kemi përkrahë si gjithëherë çdo gjë që vie në të mirën e qytetarëve të Komunës së Podujevës që do ta ketë mbështetjen, por kurrë dhe asnjëherë shkeljet dhe favorizimet e grupeve të caktuara e në dëm të interesit qytetar nuk do ta ketë mbështetjen e LDK-së.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, sa i përket çështjes së sigurisë e respektuara znj.Arnisë Sylejmani, do të thotë janë ekipet punuese qoftë para hartimit të projektit por edhe gjatë fazës së realizimit të projektit dhe nuk është se nuk ka mundësi që të zhvendoset në një pjesë tjetër çështja së trafos apo largimi i saj në një distancë më të largët nga ajo.

Duke marrë parasysh se Komuna e Podujevës nuk është se ka ndonjë komoditet të mjaftueshëm për pronat publike, aty në atë pjesë ku kërkohet që të ndërtohet Çerdhja ka qenë lokacion i domosdoshëm për ta mbuluar komunitetin e asaj ane. Po ashtu është e paraparë edhe te “Lagja e Kuvajtit” sepse edhe ajo sipas Njesisë kadastrale është me Podujevën, kështu që Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë jo vetëm për Komunën tonë por për të gjitha komunat është duke kërkuar lokacione në qytet, aty ku popullata është me numër më të madh në mënyrë që t’iu ofrohet mundësia për të vazhduar edhe me hapa tjerë.

Për çështjet tjera siç ishte ajo për burrëri, ato i diskutojmë në debate televizive, përndryshe unë po gëzohem që statusi im ju sjelli prap në sallë, kështu që kur të mungoni sërish e qes edhe ndonjë status tjetër, veç paksa më të butë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk kemi nevojë askush që të dalim jashtë temës dhe nga rendi i ditës.

(Sërish nga vendi vazhdon debati mes z.Valon Demollit dhe drejtorit parafolës z.Avni Fetahu, ku ky i pari në mënyrë të vazhdueshme disa herë pyet drejtorin se për çfarë i kërkon njërit prej kolegëve që diskutimi dhe situata të kaloj në personale si dhe duke e pyetur se kush je ti që provon “kërcënime të tilla” dhe këtë e bënë siç e thekson ai meqë është shef i Grupit të LDK-së dhe është përgjegjës për secilin prej anëtarëve të LDK-së në këtë Kuvend, ndërsa drejtori arsyetohej se në qoftë se dikush të thotë tradhtar dhe i pa burrë natyrisht se çështjes duhet t’i jepet edhe përgjigje dhe unë i’u përgjigja).

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për fjalë të tilla mund të largoheni nga mbledhja.

z.Valon Demolli, nga vendi ndërhyne duke i’u drejtuar dhe kërkuar Kryesuesit që të jetë hera e parë që i drejtohesh grupit të LDK-së në këtë formë, por të niset nga ai që i pari e filloj këtë situatë duke i thënë kolegut hajde dalim jashtë....personale, prandaj drejtohu këtij zotëriut fillimisht sepse asgjë personale nuk ka në Kuvend komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nuk është vendi këtu për politikë dhe për fushatë zgjedhore sepse nuk lejohet kurrfarë fushate politike në Kuvendin e Komunës, andaj edhe njëherë ju lus të mos dalim nga tema por të fokusohemi në pikat e rendit të ditës.

Pra ndaj secilit mund të merren masa, madje ti z.Valon Demolli e dinë këtë më së mirë sepse je edhe kandidatë për deputet, prandaj të lus të jesh i kujdesshëm.

z.Valon Demolli, sërish nga vendi, reagoj duke i’u drejtuar Kryesuesit se nuk lejoh që askush të na kërcënon neve këtu, çka ishte ajo “hajde dalim jashtë personale”

z.Naim Çunaku, theksoi, unë nuk përdori fjalor të tillë asnjëherë dhe se unë nuk lëndoj kurrë detyrën dhe misionin tim që kam, mirëpo pa dashjen tuaj zotëri Kryesues ose me tolerancën tënde ky debat çfarë është duke ndodhur në këtë Kuvend, vërtetë është i ulët.

“Shihemi në debate televizive” pastaj “ikët” “ikët prej mbledhjes”.

Kryesuesi i Kuvendit, ndërhyne duke i reaguuar parafolësit që të mos na mbaj “ders” neve këtu por të fokusohet në temë.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, nuk mund të më ndërpritet diskutimi mua ngase unë këtë fjalim duhet ta bëjë ngase duhet të jap përgjigje sepse përfaqësoj grupim politik e që në emër të grupimit politik u bë thirrje këtu për të dalë në debate televizive..

Kryesuesi i Kuvendit, sërish i reagon parafolësit që për këtë pikë nuk mund të vazhdohet më me debat, përndryshe je duke e penguar punën e Kuvendit.

z.Naim Çunaku, sërish vazhdoi, nuk mund të më ndalësh fjalën në këto raste ku atakohet një grupim politik, pra nuk mund t’ia ndalësh mundësinë për t’u përgjigjur. Kryesues je duke e keqpërdorur mikrofonin dhe je duke e keqpërdorur detyrën, andaj kërkoj të më lejosh të vazhdoj me fjalimin tim, pra ti je duke e penguar punën e Kuvendit e jo unë ngase je duke bërë favorizime dhe disfavore sepse kur dikush atakohet natyrisht se e ka edhe mundësinë të përgjigjet sikurse që kur dikush ka argument dikush tjetër ka kundër argument kaç, ngase këtu nuk jemi ata që i’a cungojmë njëri tjetrit fjalën, e me dal në debate televizive, përndryshe në debatet televizive nuk kemi përgjegjësi institucionale sepse aty kemi përgjegjësi individuale, kurse në Kuvend të Komunës kemi përgjegjësi edhe institucionale.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, përgjegjësitë i dinë secili të vetat.

Pas kësaj që u tha, unë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 26 vota Për, miratohet vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Draft Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban i Komunës së Podujevës për vitet 2025-2029

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, para vetës e keni draft Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për Komunën e Podujevës, draft ky në të cilin është punuar shumë dhe se i cili paksa është stërgjatë për shkak të angazhimit që është bërë në mënyrë që si draft në fund të del i qëndrueshëm ashtu siç e ka edhe titullin dhe të rregulloj njëherë e mirë transportin apo mobilitetin në Komunën e Podujevës.

Fillimisht pa dashur të anashkaloj këtë pjesën e vonesave që e kemi diskutuar, edhe më herët ju është përcjellë një draft që besoj e keni shqyrtuar. Pastaj me vendim të Kryetarit është ngritë një komision i ri i cili është dashur ta amandamentoj dhe korrigjoj si draft për shkak të ndryshimit të Stacionit të Autobusëve apo ndërtimit të ri të këtij Stacioni gjë që merret si bazë e këtij Plani të Mobiliteti dhe pastaj pas një pune të madhe të komisionit emrat e të cilëve mund t'i shihni në faqen e parë të dokumentit se kush ka qenë, por edhe një angazhimi të madh të shkollës teknike-drejtimi i komunikacionit rrugor ku së bashku me ta paraprakisht në bazë të analizës e cila është bërë si analizë e situatës së tanishme të transportit dhe mobilitetit në Komunën tonë nxënësit dhe komisioni kanë dhënë një kontribut ku janë bërë të gjitha matjet e qarkullimit të automjeteve në të gjitha rrugët dhe udhëkryqet e Komunës së Podujevës.

Në pjesën e fundit kemi dalë me disa propozime që ne mendojmë dhe jemi të bindur po që se mundemi në tërësi ta zbatojmë këtë Plan sigurisht se qarkullimi, transporti, lëvizja e lirë e njerëzve dhe e mallrave do të jetë në një nivel shumë më të lartë. Pra ideja është se një Plan i tillë i ka munguar Komunës së Podujevës kaherë, madje është Plani i parë i mobilitetit që bëhet në Komunën tonë, Plan për të cilin fatmirësisht kemi pas shumë ndihmë edhe prej njerëzve tjerë që janë ekspert të fushave të cilët kanë dhënë kontributin e tyre.

Pastaj krejt në fund kemi vendos edhe një kosto që ne kemi vlerësuar që do të jetë për zbatueshmërinë e këtij Plani, mirëpo më duhet t'ju them që përtej koston e cila është vendosë në këtë Plan ne kemi zhvilluar shumë takime dhe seminare me GIZ-in Gjerman ku fatmirësisht edhe Kosova është në kuadër të Ballkanit Perëndimor dhe po punohet shumë për implementimin apo lehtësimin e lëvizjes së lirë të qëndrueshme urbane të njerëzve dhe mallrave.

Përveç kësaj në takimet e fundit që kemi pas me Bankën Qendrore për Zhvillim dhe Rindërtim-BERZH ne kemi arrit që ta fusim edhe Komunën e Podujevës në një fazë të para fizibilitetit për transportin urban dhe publik në Komunën e Podujevës, prandaj të gjitha këto besoj që ju i keni lexuar dhe i keni parë, andaj ju ftoj ta votoni këtë Plan sepse është shumë i rëndësishëm për Komunën tonë, përndryshe për çdo çështje tjetër rreth këtij dokumenti mund të vazhdojmë diskutimin, mirëpo për fillim ishte kjo dhe nuk po e zgjasë më shumë.

znj.Sebastina Vokri, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim Draft Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban të Komunës së Podujevës për vitet 2025-2029.

z.Naim Çunaku, theksoi, para vetës kemi një pikë mjaftë të rëndësishme e cila i jep orientim mobilitetit në Komunën e Podujevës për vitet 2025-2029 dhe pa dashur ta përsërisë atë që tha drejtori paraprak, një plan i vonuar mirëpo gjithsesi një plan i mirëpritur që Komuna jonë të paktën ta ketë një perspektivë të ardhme për këtë çështje të paraparë si ta menaxhoj, gjegjësisht t'i jep drejtim në zhvillimin e kësaj tematike që e ka Plani në fjalë.

E kam thënë dje dhe po e them edhe sot se është një Plan ambicioz, një Plan i mirë për tu lexuar, një Plan që çdo njërin prej nesh na bënë të ndihemi mirë nëse në fund të kësaj periudhe kohore pesë vjeçare do e shihnim të realizuar të paktën gjysmën e tij, mirëpo me një kosto financiare e cila është paraparë prej 7,463,280€ dhe gjithë fushëveprimin të cilin e parasheh në standardet për të mos thënë e barazon Podujevën me qytetet e zhvilluara, të paktën ashtu siç Plani e parasheh. Uroj

që ky Plan të realizohet në përpikëri dhe pavarësisht se dikush mendon që ta bëjë dikë idhnak që të mos votoj në të mirën e qytetarit ne nuk hidhërohem kur është interesi i qytetarit pavarësisht asaj që dikush mendon që ta bëjnë një grupim të caktuar që po e pengon zhvillimin e qytetit.

Shohë disa qasje që vërtetë më bëjnë të dyshoj që mund të implementohen, nuk dua të jem dashakeq por uroj që të implementohen, mirëpo me vetë faktin që ne në fund të mandatit tonë dhe të kësaj qeverisje lokale e kemi një Plan të tillë është tregues se sa mund të implementohet, e them këtë sepse ta lexosh e përpunosh materialin na del që pjesa dërmuese e projekteve janë të parapara të realizohen në vitin 2028-2029, pra në vitin e fundit të afatit kohor për realizimin e këtij Plani, dhe marrë nga këndi ynë do të thotë jo kjo qeverisje por edhe qeverisja e ardhshme lokale do ta ketë në fund dhe një Plan si ky, unë besoj dhe do të duhej që të jetë në fillim të mandatit e në veçanti të fillimit të mandatit të qeverisjes tjetër në mënyrë që të realizohet.

Nuk dua të mbjell skepticizëm, por ta shohë Podujevën në vitin 2029 me tramvaj, metro, makina elektrike ekologjike, vërtetë kjo është shumë e dëshirueshme e që besoj se duhet të jemi pak më racional duke pasë parasysh gjendjen në të cilën gjendemi në Komunën e Podujevës andaj them se kjo është goxha e pa realizueshme që të bëhen këto në këtë afat kohor, mirëpo ambiciet nuk duhet të na mungojnë kurrë dhe sigurisht në atë kuptim e kanë pasë për bazë këtë edhe hartuesi i këtij Plani në të cilin një pjesë të mirë më tepër se 6-7 faqe e shpjegon lëvizjen aktive apo krijimin e hapësirave për lëvizje të lirë të qytetarëve e në veçanti zhvillimit të çiklizmit si trend edhe i shëndetit dhe mos ndotjes së ambientit, pastaj hollësisht na janë paraqitur të dhënat teknike sa duhet me u përmbajft ato staza që është mirë që ka Plane dhe çfarë dimensionesh, por kur do të realizohen ato e që kryesorja është realizimi i tyre nuk e kemi të ditur.

Te rregullimi i sinjalistikës, dhe po e përmbylli me këtë edhe pse e kemi marrë materialin i cili ka më shumë se 100 faqe, thotë do të sigurojmë siguri në komunikacion me sinjalistikën e nivelit bashkëkohor të kohës për çka kam veç një pyetje, para 5-6 viteve sa mua më duket krejt portalet, meqë u përmenden portalet, të gjitha portalet gjithandej Kosovës kanë shkruar se Podujeva u bë me një semafor dhe pyes të gjithë ne dhe gjithë qytetarët kur për 5 vite një semafor nuk është në gjendje të mirëmbahet, sa mund t'i besojmë metros, çiklizmit, automobilave ekologjik, tramvajit.

Çdo propozim që vie në këtë Kuvend, Lidhja Demokratike e Kosovës gjithmonë do të jetë pro vendimeve që qojnë në zhvillim dhe mirëqenie të qytetarëve e që askush nuk mund ta marrë primatin për mirëqenien e qytetarëve, pra as individit e as subjektet.

znj. Tringa Sfishta, theksoi, a ka mundësi të di se në cilën periudhë kohore do të lëshohet tramvaji i cili ishte paraparë në këtë Draft Plan të Mobilitetit.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ne Grupi i PDK-së e përkrahim këtë Plan të Mobilitetit të Qëndrueshëm. Është hera e parë që është punuar një Plan i tillë dhe është e ditur që do të ketë sfida në realizimin e tij, pra sigurisht këtu mund të ketë sfida dhe aty ku nuk mund të zbatohet ky Plan të ndryshohet dhe është mirë t'i rekomandohet komisionit që të përshtatet dhe të bëhet sa më profesional në të mirë të qytetarëve të Komunës tonë.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht që Draft Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban i Komunës së Podujevës për vitet 2025-2029 e konsiderojmë që është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm në interes të qytetarëve dhe mbi të gjitha në këtë Plan parashihen ashtu siç e ceku edhe drejtori i DSHPMSh shumë investime milionshe për Komunën tonë, për qytetarët e Komunës tonë, dhe natyrisht se ky Plan ka një afat e që nuk u tha që është në vitin 2025, por është 2025-2029, pra ka një periudhë kohore mbi të cilat parashihen investime dhe do të jem shumë i kënaqur nëse të gjitha grupet me të vërtetë interesohen dhe i përkrahin investimet që bëhen në Komunën e Podujevës, sepse kështu kemi vepruar edhe ne në Plane, draft plane dhe në dokumente të ndryshme, investime që janë ardhë nga jashtë, natyrisht që i kemi përkrahur, pavarësisht që i

kemi edhe ato qëndrimet politike si Parti politike të ndryshme por diçka që është në interes të qytetarëve jam shumë i kënaqur dhe i lumtur që të ketë mbështetjen e të gjithëve.

U tha që është Plani i parë i tillë, por besoj që është shumë i rëndësishëm e mbi të gjitha do të ketë investime të shumta për këto vite 2025-2029.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, ashtu siç e theksoi edhe kolegu z.Naim Çunaku, ne jemi pro këtij dokumenti por kam disa pyetje për drejtorin e DSHPMSH; pyetja e parë është tek faqja 23 e dokumentit ku sa e pash të dhënat e popullsisë i keni marrë ato të vitit 2011, a ka ndryshuar kjo meqenëse numri i popullsisë sipas statistikave dihet se sa ka dalë me regjistrimin e fundit e që është dashtë të merret numri i popullsisë sipas regjistrimit të vitit 2024 e jo ai i vitit 2011, gjithashtu te faqja 81, ka paqartësi sa i përket implementimit dhe mungesës së planifikimit financiar te përmbledhja e masave të Planit të implementimit, do të thotë ekziston rubrika e pjesës financiare mirëpo nuk ka të dhëna.

z.Fatmir Gashi, theksoi, jam i kënaqur që edhe pse vonë më në fund ka arrit ky draft Plan para Kuvendit të Komunës për diskutim dhe shqyrtim të hollësishëm, është një Plan jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe besoj që në hartimin e këtij drafti Komuna jonë duhet të kuptojë mirë e mirë problemet aktuale të rrjetit të transportit dhe të identifikoj të gjitha zgjidhjet e mundshme.

Qëllimi duhet të jetë që qyteti dhe vendbanimet të lëvizin drejtë praktikave të qëndrueshme të transportit që ndihmojnë në arritjen e objektivave të transportit të qëndrueshëm dhe cilësisë së ajrit, dhe po ashtu duhet ta përmirësojmë gjithsesi gjendjen aktuale të trafikut, transportit dhe parkingut me qëllim të ndryshimit të sjelljes dhe nxitjes së ndryshimit drejtë alternativave të qëndrueshme dhe jo të vijmë në një situatë jo të mirë siç kemi shembullin që hyrjen e oborrit të kësaj Komune ta shndërrojmë parking për shkak të mungesës së tyre siç ishte ajo situatë që tani më nuk është.

Si shumë qytete tjera edhe Komuna jonë e sidomos qyteti vuan nga mbi ngarkesa në trafik e që ka efekte negative në sigurinë e lëvizjes, në ekonomi, mjedis dhe imazh të qytetit, ndërsa cilësia e ajrit është shumë e rëndësishme sidomos në atë të përmirësimit të standardeve të Bashkimit Europian ku duhet të kemi parasysh përmirësimin e lidhshmërisë dhe qasjes, zhvillimin dhe inkurajimin e përdorimit të trafikut jo motorik në qytet, përmirësimi i sigurisë rrugore, përparësia e transportit publik ndoshta edhe pse sot qyteti ynë nuk është aq i mbingarkuar aq sa qytetet e mëdha por në të ardhmen të parashihet kjo gjendje.

Pastaj në zgjedhjen e problemit të parkingjeve, uljen e ndikimit negativ të mjedisit të qëndrueshëm duhet të bashkëpunohet shumë me nivelin qendror për të krijuar modele të reja të kohës dhe përmirësimin e politikave për zhvillim të qëndrueshëm bashkëkohor sepse jemi pjesë e saj e sidomos edhe vet e cekët se Komuna jonë dhe Kosova janë pjesë e Evropës Juglindore apo siujdhesës Ballkanike.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar drejtor i DSHPMSH harrova edhe diçka, duke parë trendin e migrimit të popullsisë tonë mendoj që tek ky draft Plan i Mobilitetit të shqyrtohet mundësia dhe të mundohemi të krijojmë ndonjë alternativë financuese që Komuna jonë të artikulojë vizionin për një diçka në të ardhmen kur e kemi parasysh faktin që në këto vite kemi banorë më pak, prandaj a ka mundësi dhe a do të mundnim të inkorporojmë në këtë Plan një transport të subvencionuar nga Komuna ngase besoj shumë që banorët e Komunës së Podujevës shkak i distancës gjeografike që kemi me qendrat ku punojnë dhe veprojnë është një prej shtytjeve që e bëjnë të largohen prej vendit, dhe ne si Komunë në këtë rast si vendimmarrës të kësaj Komune a do të duhej dhe a do të mund të hulumtojmë mundësitë që të bëhet një transport i subvencionuar, kjo me të vetmin qëllim lehtësimin dhe ruajtjen e materies apo banorëve të Komunës së Podujevës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, lidhur me sigurinë e këmbësoreve që u cek, të ketë kalime të sigurta për këmbësorët në nivel, mbi nivel dhe nënkalime apo mbi kalime, a ka mundësi të bëhen këto apo do mbesin veç në letër, pra a do të realizohen dhe në cilat vende parashihen këto nënkalime ose mbi kalime.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, faleminderit shumë për të gjitha këto pyetje e sugjerime, fillimisht më vie shumë mirë dhe jam shumë falënderues që është kaq i mirëpritur ky Plan i Mobilitetit të Komunës së Podujevës.

Po mundohem pak a shumë të jap sqarime për këto që u diskutuan, sa i përket buxhetit veç u cek në fillim që nuk është e mjaftueshme për implementimin komplet të këtij Plani por e ceka se ne kemi pasë shumë takime në shumë seminare edhe jashtë Kosovës dhe si Komunë kemi qenë si në mesin e tri komunave, pra vetëm tri komuna të Kosovës kanë qenë të përfshira në projektin e GIZ-it i cili është në kuadër të Ballkanit Perëndimor dhe atë Komuna e Podujevës, Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Graçanicës, vetëm këto 3 komuna kanë qenë të përfshira këtu e që ne kemi marrë zotime që ai projekt është duke vazhduar ende që të kemi mbështetje financiare por edhe mbështetje me projekte të ndryshme për implementimin e këtij Plani të Qëndrueshëm Urban të Mobilitetit në Komunën e Podujevës sikurse dy komunat tjera që jemi bashkërisht në këtë projekt të madh të GIZ-it.

Po ashtu i ceka edhe takimet e fundit që kemi pasë me BERZH, dhe puna apo lehtësimi më i madh për Komunën tonë që ka hyrë si Komunë në kuadër të 7 regjioneve të Kosovës, Komuna jonë ka hyrë si e vetme për shkak të territorit të madh që ka sepse ky projekt ka qenë i planifikuar për regjionet e Republikës së Kosovës por në bazë të takimeve që kemi pasë si Komunë kemi hyrë në bashkëpunim që të bëhet një analizë fizibiliteti për komplet transportin rrugor në Komunën e Podujevës ku përfshihen pothuajse të gjitha ato çka ne i kemi paraparë në Plan dhe kjo do të na ndihmoj shumë sepse BERZH është ajo e cila na ndihmon shumë edhe për transportin edhe për ambientin se ndotja e ambientit ceket edhe në Plan që ishte një ndër pyetjet e shtruara.

Tani një pyetje më shumë mu duk si komike kur u tha se kur do të bëhet tramvaji, ky është një Plan i detajuar i cili është bërë prej një ekipe shumë profesionale, kanë qenë të gjithë të zgjedhur ekspert të komunikacionit dhe nuk na është paraqitur asnjë problem që ne të parashohim edhe tramvajin në të ardhmen ku e bënë edhe ruajtjen e ambientit dhe e lehtëson qarkullimin e një unze apo qarkullimin në qytetin e Podujevës, mirëpo fokusi kryesor ka qenë transporti që tani e kemi ai me autobus, pra fillimisht ne së pari duhet ta rregullojmë transportin me autobusë mirëpo në implementimin e tramvajeve kjo sigurisht do të varet shumë edhe prej analizës së fizibilitetit që ka filluar nga BERZH. Sa i përket metros ne veç thuajse kemi filluar të bëjmë diçka në këtë drejtim, kemi kërkuar që komplet hekurudha e cila kalon nëpër qytet të kaloj nën tokë e të mos preket qyteti dhe të krijohet siguria e këmbësorëve që u cek në një pyetje tjetër, do të thotë ne kemi dërguar kërkesë në Ministri dhe tani më duket se ka filluar projektimi i komplet hekurudhës e cila kalon edhe nëpër qytetin tonë dhe me gjasë hekurudhën do ta shohim nën tokë ashtu siç janë zotuar ata, ashtu siç është projekti dhe kjo është një ndër metrot sepse hekurudha kalon nën tokë dhe mund të ketë stacione mbi tokë e që nuk e pengon aspak komunikacionin e automjeteve tjera por edhe siguron siguri për këmbësorët.

Te mbrojtja e ambientit u përmenden edhe veturat elektrike, tash makinat elektrike veç se kanë filluar të hyjnë në treg, madje ne tani veç e kemi kërkesën e parë prej operatorëve të taksive, radio taksive që me i fut makinat elektrike në treg dhe jemi në fazën e dhënies së lejeve për disa kompani të mëdha që punojnë taksitë e që do të eliminojnë makinat që punojnë me derivate duke vazhduar punën e tyre me makinat me rrymë që janë shumë ruajtëse dhe mbrojtëse të ambientit.

Te çiklizmi dhe shtigjet, tashmë duhet të them se para 3 viteve në Komunën e Podujevës nuk ka qenë asnjë metër e ndërtnuar me shteg të biçikletave kurse tani ne kemi mbi 15 km e që kjo nënkupton që ne kemi punuar në këtë drejtim. Kemi pasë shumë vështirësi të gjejmë hapësirë për të bërë shtigje të biçikletave, por plani është 4 vjeçar dhe besoj që brenda 4 viteve të kryhen edhe shumë punë të tjera në shtigje të biçikletave, sepse i kemi kushtuar shumë rëndësi lëvizjes së lirë edhe pa pasur fare plan të mobilitetit, e lëvizja e lirë është kjo me biçikleta që ne veç i kemi krijuar shtigjet dhe kemi siguruar këmbësorët dhe ngasësit e biçikletave në këtë rast.

Te sinjalistika, u përmend semafori e që kemi fol shumë herë për semaforin e Podujevës dhe nuk kam diçka tjetër përtej asaj që e kam thënë, e para është se vendosja e semaforit ka qenë gabim edhe me atë semafor janë marrë inxhinierët dhe ekspertët e komunikacionit që ne i kemi angazhuar dhe i kanë bërë matjet në secilin udhëkryq, janë bërë matjet bashkë me nxënësit se sa automjete kalojnë brenda atij udhëkryqi në secilin drejtim dhe kanë ardhë në përfundim se ai semafor është i pa nevojshëm dhe është vendosur gabimisht, përndryshe nuk është aspak problem të bëhet funksional sepse thuajse funksional është dhe tani, por kurdo që dëshironi një tollovi në trafik e lëshojmë e provojmë edhe një herë, nuk është problemi aty por problemi është kur ekspertët i kanë bërë matjet del që ai semafor është i pa nevojshëm.

Te popullsia, ishte një pyetje që unë e kam pasë regjistrimin parafundit që ka qenë e që nuk ndryshon shumë me regjistrimin e fundit në vitin 2024, por nuk ka qenë zyrtare regjistrimi i fundit për tu përfshirë në këtë Plan, gjithçka që nuk është zyrtare ne nuk mund ta fusim në Plan, por ky Plan ka edhe mundësinë e plotësim ndryshimit e që besoj ndoshta edhe me idenë e juaj dhe me idenë e secilit që është ekspert i kësaj fushe ne në një të ardhme do të mund të bëjmë ndryshim plotësim të këtij Plani, me rëndësi është të implementohet dhe të duket mirë ashtu siç është.

Te kostoja e pjesës financiare që u cek, te tabela ku znj. Arnisa Sylejmani e potencoi që te një pjesë është e përfshirë kostoja, fakt se te një pjesë është e përfshirë kostoja si paramasë dhe parallogari e koston që mund të na shkaktohet në implementim, ndërsa pjesa tjetër ka mbet që të diskutojmë me ato ndihmesat financiare që mund t'i kemi nga jashtë dhe ta implementojmë sepse të bëhet planifikimin komplet për këtë Plan, buxheti është jashtëzakonisht i madh dhe si Komunë nuk mund ta përballojmë, mirëpo atë që ne kemi menduar që brenda këtij Plani brenda 5 viteve që është afati është ajo kosto që veç e kemi paraqitur si paramasë dhe parallogari.

Një pyetje shumë e rëndësishme ishte subvencionimi i linjave apo i transportit, gjë për të cilën po kemi shumë probleme për shkak të dyndjes së popullsisë dhe numrit jo të mjaftueshëm të udhëtarëve nëpër linja urbano periferike, në këtë drejtim kemi filluar ta bëjmë një projekt të ri të cilin besoj shumë shpejt do ta keni paravetës, fillimisht kemi angazhuar zyrtarë të Drejtorisë të merren me këtë çështje dhe kemi menduar se është e pa mundshme ta mbajmë funksional transportin tani siç është në këtë formë. Ne e dimë që për çdo ditë kemi probleme me linjat e transportit privat për shkak të mungesës së udhëtarëve ku detyrohen të mos e mbajnë vijën e që ne nuk mund t'i obligojmë ta mbajnë vijën sepse ajo është private dhe mund ta lë kur të dojë por krejt çka mund të bëjmë është t'ia revokojmë lejen e që nuk është interes i yni sepse është në dëm të qytetarëve. Në këtë aspekt po i përmendi 3 fshatra të cilat vazhdimisht janë me probleme, është Dumnica që ka probleme me transport dhe që gjithëherë e kanë ngritë këtë shqetësim dhe nuk kemi mundur asnjëherë të bëjmë zgjidhje edhe pse jemi munduar shumë bashkërisht me banorët e asaj pjese, tani së fundmi edhe në Sibofc është ndalë transporti dhe mungon qarkullimi i nxënësve, gjithashtu edhe në Repë është i njëjti problem. Duke i analizuar gjithë këto gjëra ne kemi filluar tash me subvencionimin e linjave të cilat nuk mund t'i tregoj në detaje sepse marrin shumë kohë mirëpo shumë shpejt do ta shihni si projekt të ri subvencionimin e linjave urbano periferike dhe urbano periferike rurale sepse këto i kemi aktualisht në funksion e pastaj ta bëjmë edhe trafikun

urban së shpejti. Prandaj me zgjidhjen e kësaj problematike duke subvencionuar operatorët më nuk do të kemi probleme me linja sepse Komuna merr përsipër secilën linjë në bashkëpunim me operatorët privat ku të gjitha mjetet e mbledhura derdhen në Komunë e pastaj operatorët paguhen në bazë të kilometrave për punën e tyre, kështu që nuk ka më interesim a ka udhëtar apo nuk ka, por interesi për operatorin do të jetë sa kilometra i bënë ai, pra operatori bënë ato kilometra që i ka në linje dhe pagesa i bëhet për ato kilometra, prandaj e them se e kemi filluar këtë punë dhe besoj se shumë shpejt edhe ju do e keni para vetës materialin ku kemi menduar se me këtë çështje do ta zgjidhim këtë problem që e kemi të shfaqur tani e një kohë.

Siguria për këmbësor, mbikalimet dhe nënkalimet, ishte pyetja e fundit, tani jemi duke e bërë projektin e një mbikalimi që është në rrugën magjistrale që vie prej fshatit Balloc ku të gjithë këmbësorët kalojnë përmes rrugës magjistrale dhe dalin në pjesën tjetër, pra aty kemi filluar ta bëjmë projektin dhe do e bëjmë një urë, një mbikalim për këmbësorët, pra pas një jave na vie projekti i detajuar. Pastaj kemi ndarë buxhet të cilin e keni votuar ju këtu në Kuvend në vlerë 100,000.00€ për ndërtimin e urave. Javën tjetër besoj se do e shihni të publikuar projektin e atij mbi kalimi i cili e bënë një zgjidhje shumë të mirë për një numër shumë të madh të këmbësorëve të asaj pjese, dhe pjesa tjetër që kemi ndarë një buxhet prapë për një trotuar shtesë në urën e Orllanit e cila paraqet shumë rreziqe për këmbësorët sepse është shumë e ngushtë dhe nuk ka trotuar fare si dhe paraqet rrezik për qarkullim të nxënësve e që për atë urë kemi ndarë një buxhet të cilin ju e keni votuar në vlerë 50,000.00€ ku do e bëjmë një aneks të asaj ure me një zgjerim me konstruktion të hekurit vetëm për qarkullim të këmbësorëve të asaj pjese.

Për pjesët tjera, për nënkalime dhe mbikalime sigurisht se do të bëjmë analiza më shumë, i kemi të parapara edhe aty ku na jepet mundësia ku nuk bëjmë pengesa për qytetarët dhe sigurisht se do të punojmë shumë në këtë drejtim sepse interesi në ruajtjen e sigurisë së këmbësorëve është mbi interesat e gjithë të tjerëve.

znj. Donjetë Sheqiri, theksoi, meqenëse edhe vet parafolësi drejtor i DSHPMSH e përmendi linjën Dumnicë-Podujevë, unë e kam parashtruar disa herë këtë çështje në Kuvend por fatkeqësisht nuk kam marrë përgjigje sepse disa herë nuk keni qenë prezent këtu, pra kam parashtruar kërkesë që të paktën të bëhet një zgjidhje afat shkurtër deri sa të bëhet ajo që e cekët me një linjë me tri relacione, do të thotë të paktën tri herë brenda ditës që fëmijët të mos kenë më mungesa nëpër shkolla për shkak të mungesës së transportit, mandej edhe taksitë që janë nuk do të thotë që i përmbushin kërkesat dhe nevojat e tyre, prandaj të paktën kam kërkuar edhe më herët dhe po kërkoj prapë që të bëhet një zgjidhje afat shkurtër deri sa të bëhet zgjidhja tjetër meqë edhe vetë ju drejtor përfshitë në këtë temë.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, në mbledhjen e kaluar shpaleshe një Rregullore duke e lexuar dhe interpretuar gabim (më ka dhënë nënshkrim s'më ka dhënë nënshkrim) por që e shfrytëzove autoritetin tënd dhe modestinë time, andaj mjaftë se nuk kalon më ashtu, unë e di saktë çka kam të drejtë, njëherë diskutova në emër të Grupit dhe për këtë jeni dëshmitar, herën e dytë si Naim dhe herën e tretë kam të drejtë për tre minuta plotësues, prandaj mos të lutem sepse nuk të çon askund kjo formë sepse e mbytetë debatin.

Kryesuesi i Kuvendit, kërkon nga parafolësi që të mos e zgjat më shumë debatin rreth kësaj çështje por të kthehet në temë.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, ti Kryesues po më shtinë ta zgjas debatin.

I nderuar drejtor i DSHPMSH, deshta të të them se në diskutimin tim po më vie mirë që propozimi im paska gjet vend dhe po u mendojka për subvencionimin e transportit publik, por ajo çka s'mund të pajtohem me ty është te numri i banorëve që e potencove se është i përafërt me regjistrimin e

vitit 2011 me atë të vitit 2024, me keqardhje e them se është një trend i migrimit dhe kur u tha për subvencionim unë mendova t'ju krijohen kushte të nevojshme që qytetarët të mos ikin nga vendi.

Në vitin 2011 Komuna e Podujevës zyrtarisht sipas regjistrimit të popullsisë i ka pasë mbi 84000 banorë kurse në regjistrimin e fundit Komuna e Podujevës ka 71000 banorë, do të thotë paraqitet një diferencë, një migrim prej 13000 qytetarëve të Komunës së Podujevës, e çka është e vërteta se nuk është e saktë kjo se nuk është kalkuluar nataliteti ndër vite. Prej vitit 2011 deri në vitin 2025 nuk është kalkuluar një natalitet që mesatarisht në krejt Komunën është rreth 5000 banor, shtu edhe këto dhe Komuna e Podujevës tani është dashur t'i ketë mbi 110000 banor.

Për fund kam një sugjerim i cili besoj se duhet të gjej vend në këtë Plan kur bëhet fjalë për këmbësorët dhe shtigjet e biçikletave që në një periudhë kohore si vizion dhe si diçka për të ardhmen, brigjet e lumenjve e në këtë rast brigjet e lumit Llap, njërën anë të brigjeve të lumit Llap të ndërtohet një shteg për biçikleta dhe për këmbësoret e që kjo do ndikonte në ruajtjen e ambientit dhe do e lehtësonte qarkullimin e këtij segmenti rrugor, besoj shumë që banorët që janë 3-4 km s' do i ndiznin makinat por do udhëtonin me biçikleta.

Nuk mund të pajtohem me atë që cekët për semaforin që është krejt në rregull për të cilin nga dikush këtu u tha se ka qenë lajm në krejt Kosovën, mirëpo Podujeva as me auto shkollë nuk ke pasë ku të ndalesh, pra Podujevës as auto shkolla s'ka mund t'ia tregoj semaforin kandidatit sepse nuk ka pasë semafor në Podujevë, por që është ndërtuar një semafor, prandaj konstatimi i juaj drejtor fare nuk po hyj sa është i qëndrueshëm ose jo në rregull, në një formë ju e thatë që ka paraqitë pengesë, mirëpo parashtrohet pyetja edhe sot e kësaj dite, semafor funksional në Komunën e Podujevës nuk ka, a e keni hallin edhe të këtyre të auto shkollës drejtor.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, sërish e mora fjalën me qëllim që të mos i mbetem borxh askujt sa i përket përgjigjeve dhe sqarimeve.

Sa i përket transportit për Dumnicë, e nderuara zonja Donjetë përveç që e kemi diskutuar këtu në këtë e kemi diskutuar edhe me qytetarët dhe nuk është ofruar një zgjidhje, unë e thashë në foltore se është transport dhe është linjë private, krejt çka mund të bësh është kësaj linje private t'ia revokosh lejen e që mendoj se nuk është zgjidhje për banorët. Ne kemi insistuar në forma të ndryshme dhe po ju tregoj tani publikisht se shumë herë ai operator atë linje e ka mbajtur vetëm për hatër, tash së fundi deri sa te merr një formë ky subvencionimi merr kohë, kemi menduar që këto linja t'i subvencionojmë të paktën me një ndihmë të vogël që të mos të shuhen, andaj besoj që nxënësit prapë nuk do të mbesin pa transport edhe pse ky është problem i vjetër që jemi munduar ta zgjedhim disa herë dhe nuk kemi mundur asnjëherë. Pa e bërë transportin publik kur t'i e ke në dorë dhe e dërgon kurdo që të duash, të tjerët mund të "luajnë" me neve sepse janë operator privat, mirëpo kur të bëhet transporti publik edhe nëse autobusi është thatë ai do shkojë në atë linjë, ndërsa sa i përket operatorëve privat ata në momentin që ndalin linjën leja i revokohet vet automatikisht.

Ideja juaj zotëri Çunaku për ndërtimin e shtigjeve përreth shtratit të Lumit Llap më pëlqeu shumë, por mendoj se kjo është një kosto e madhe ngase fillimisht shtrati i lumit duhet të rregullohet shumë mirë e pastaj të mendohet për këmbësorët dhe shtegun për çiklistët sepse tani në këtë gjendje nuk mund ta bëjmë një gjë të tillë ngase në këtë vit do fillojmë me rregullim të shtratit të lumit Llap me buxhetin që ka ndarë Qeveria për Komunën e Podujevës, andaj kur të rregullohet kjo do bëjmë një projekt të ri ku do të planifikojmë shtigjet për ecje dhe biçikleta, përndryshe ne kemi pasë ide ta bëjmë një shteg për biçikleta në pjesën Lluzhan-Orllan që është një pjesë bukur e frekuentuar, mirëpo hapësira po na kufizon shumë por edhe kostoja e madhe që është në atë pjesë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se debati përfundoj për këtë pikë të rendit të ditës, andaj e hedh në votim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 26 vota Për, me vendim miratohet Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban i Komunës së Podujevës për vitet 2025-2029, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Nga disa prej anëtarëve të Kuvendit kërkohet pauzë për 1 orë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, personalisht sot jam kundër që të shkojmë në pauzë për arsye se kam disa çështje personale, konkretisht për të marrë pjesë në një varrim në ora 15:00 të një të afërmi tim i cili është edhe i afërm i asambleistit z.Kasib Bashota, andaj nëse është e mundur të vazhdojmë me pikat në radhë ngase edhe ashtu nuk janë shumë dhe ta përfundojmë këtë mbledhje. Përndryshe nëse shkojmë në pauzë deri në ora 14:00, apo deri në 13:30, sikurse herëve tjera një pjesë e asamblistëve sigurisht se do të vonohen dhe pastaj vetëm shtyhet vazhdimi i mbledhjes, mirëpo pavarësisht kësaj e hedh në votim propozimin për pauzë deri në ora 14:00.

Pas votimit u konstatua se meqë nga 22 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, 8 vota ishin Për, 16 vota Kundër, nuk kalon kërkesa për pauzë.

z.Valon Demolli, reagon duke theksuar dhe duke shfaqur pakënaqësi për mos dhënien e pauzës duke theksuar se do të mund të shkonim në pauzë dhe të ktheheshim për të vazhduar mbledhjen në ora 13:30, apo edhe pas atij varrimi nga ora 16:00, pse jo.

Grupi i LDK-së përkohësisht lëshon sallën si pakënaqësi për mos dhënien e një pauze.

Kryesuesi i Kuvendit, konstaton se 18 anëtar/e të Kuvendit janë prezent në sallë dhe mund të vazhdohet me punë sepse kuorumi ekziston.

4. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, materialin, përkatësisht raportin në fjalë sigurisht e keni marrë me kohë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

z.Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e përkrahim raportin e Punës së Kuvendit për vitin 2024. Kërkojmë që në të ardhmen që merret edhe më shumë për bazë Plani i punës së Kuvendit për vitin përkatës, por si Grup e përkrahim.

Kemi pas rreth 108 akte që janë nxjerrë nga ky Kuvend dhe mendoj se është një punë e mirë që është bërë nga anëtarët/et e Kuvendit të komunës së Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth këtij raporti, nëse jo atëherë duke qenë në dijeni se raporte të tilla nuk votohen, e konsiderojmë të përfunduar edhe këtë pikë të rendit të ditës.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendi të ditës.

5. Raporti vjetor për vitin 2024 i Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, rreth këtij raporti fjalën i’u japim z.Burim Hasanit i cili është edhe anëtar në Komisionin e aksionarëve në Ndërmarrjen në fjalë

z.Burim Hasani, theksoi, sot për këtë pikë jam në cilësinë e anëtarit të komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” në Podujevë dhe do të bëjë prezantimin e raportit vjetor preliminar të punës së ndërmarrjes për vitin 2024.

Kujtojmë se kjo Ndërmarrje është themeluar më 22 prill 2024 për të ofruar shërbime publike dhe për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës së Podujevës dhe ka për qëllim për të krijuar një qytet më të pastër, më të gjelbër dhe më të zhvilluar për brezat që do të vijnë pas.

Kuptojmë se kjo Ndërmarrje në veprimtarinë kryesore ka një gamë të gjerë të shërbimeve që ofron, duke filluar nga mirëmbajtja e gjelbërimit, mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve, mirëmbajtja e varrezave, menaxhimi i parkingjeve publike, dekorimi i hapësirave publike, mirëmbajtja e objekteve publike banesore, mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve, pyllëzimi i sipërfaqeve dhe hapësirave gjelbëruese, mirëmbajtja e ndriçimit publik si dhe deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi në objekte dhe hapësira publike.

Duke pasqyruar parasysh në përmbledhjen ekzekutive që është mbajtur gjatë muajin e fundit të vitit 2024, Ndërmarrja në fjalë ka punuar me angazhime të larta drejt përmbushjes së qëllimeve të përcaktuara për menaxhimin e kontratave si dhe zbatimin e projekteve të cilat do të ndikojnë drejtpërsëdrejti te qytetarët.

NPL “Eko-Llapi” e ka përmbushur vitin 2024 me 32 punonjës në këtë Ndërmarrje si dhe me 6 kontrata të bashkëpunimit.

Kontratat dhe marrëveshjet në vitin 2024 janë, mirëmbajtja e hapësirave të brendshme, mirëmbajtja e hapësirave publike, renovimi dhe ngjyrosja e objekteve, mirëmbajtja e ngrohjes qendrore në objektet komunale, mirëmbajtja e elektrikes në objektet komunale si dhe larja e automjeteve.

Kuptojmë se te mirëmbajtja e hapësirave të brendshme kemi objektet komunale ku përfshihen Komuna, Emergjencia, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Teatri si dhe Galeria e Arteve.

Duke pasqyruar parasysh te kontrata për mirëmbajtjen e hapësirave të jashtme, kemi mirëmbajtjen e hapësirave të jashtme ku ka për qëllim sigurimin e shërbimeve të rregullta efektive për ruajtjen e pastërtisë, gjelbërimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike në territorin e Komunës së Podujevës.

Përveç kontratës për mirëmbajtjen e hapësirave publike, kemi edhe renovimin dhe ngjyrosjen e objekteve, kontratë e cila është nënshkruar në vitin 2024 e që ka për qëllim renovimin dhe ngjyrosjen e objekteve duke përfshirë shkollat, objektet komunale, qendrat e fëmijëve si dhe hapësirat publike ku ka për qëllim përmirësimin dhe ruajtjen e kushteve dhe infrastrukturës ekzistuese në objekte publike.

Pastaj kemi edhe mirëmbajtjen e ngrohjes qendrore në objekte komunale si dhe mirëmbajtjes së elektrikes në objekte komunale e po ashtu së fundmi e kemi marrë edhe kontratën dhe marrëveshjen për larjen e automjeteve zyrtare e që kjo kontratë përfshinë larjen e automjeteve që ka për qëllim sigurimin e shërbimeve të pastrimit të automjeteve në të gjitha institucionet komunale duke përfshirë veturat zyrtare, veturat e shërbimit të zjarrfikësve, ambulancat si dhe çdo automjet tjetër që përdoret nga shërbimet dhe departamentet e ndryshme të Komunës së Podujevës. Mbi të gjitha këto vlen të theksohet se gjatë vitit 2024 NPL “Eko-Llapi” ka bërë një sërë marrëveshjesh të mira në lidhje me bashkëpunimin me Komunën ku Komuna po ashtu i jep kësaj

Ndërmarrjeje 2 vetura në shfrytëzim për nevojat e saj, pastaj marrëveshja e dytë është me zyrën e punësimit ku kemi të bëjmë me masën 1.8 - Qeveria për familjet, si dhe po ashtu marrëveshjen për anëtarësimin e NPL "Eko-Llapi" në Shoqatën për pastërti të ambientit të Kosovës që është Organizata Pamkos. Gjithashtu kemi edhe një kontratë me Agjencinë Qendrore të Prokurimit që është për furnizim me karburante.

Përveç këtyre kemi edhe listën e aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2024 ku janë realizuar një sërë aktiviteteve nga kjo Ndërmarrje.

Të hyrat nga kontrata për mirëmbajtjen e hapësirave publike mund të përmendim që kemi ujitjen e sipërfaqeve gjelbëruese 255 ari, ujitjen e drunjtëve dekorativ 638 drunj, mandej kemi prerjen dhe kositjen e barit te Parku i Paqes, në rr."Ali Ajeti", në sheshin "Ali Ajeti", oborret e Ambulantave të Mjekësisë Familjare, Zyrat e Gjendjes Civile, në Objektet Kulturore, Çerdhet Publike si dhe parqet në fshatra dhe po ashtu edhe rreth rrotullimet, ku kemi të bëjmë me një vlerë rreth 416885 m².

Po ashtu kemi edhe mbledhjen e mbeturinave ku në bazë të m² janë të mirëmbajtura parku i qytetit, parku i paqes, parku i komunitetit te liqeni i Batllavës, parqet në fshatra si dhe objektet kulturore sportive dhe rreth rrotullimet ku kemi të bëjmë me një sipërfaqe prej 887356m².

Po ashtu kemi kontratën edhe për mbjelljen e gjelbërimit të ulët të barit 500m², pastaj prashitja e gjelbërimit të lartë 233 copë ku këtu përfshihen drunjtë dekorativ. Spërkatja e trotuareve për eliminimin e barojave 2480m² ku në kudër të kësaj hyjnë trotuaret dhe skajet e rrugëve, mandej kemi pastrimin e fontanave.

Po ashtu punë tjetër që është bërë gjatë viti 2024 është edhe pastrimi i shtratit të lumenjve nga mbeturinat me dorë ku janë 9885m², pastaj vlen të theksohet se është edhe mirëmbajtja e mobilierisë urbane, larja e ulëseve, dritave dhe shportave ku janë 98 copë, pastaj trajtimi i gjelbërimit të lartë me molcher, prerja e degëve përgjatë rrugëve të cilat janë pengesa për këmbësorë dhe për vizitës ku janë 808 copë, mandej kemi largimin e pengesave tjera nëpër trotuare ku janë 264 copë, e po ashtu edhe pastrimi i xhamave të brendshëm në objektet publike 1300m², si dhe eliminimi i rreziqeve nga kulmet e objekteve publike banesore ku kemi pastrimin e ujëmbledhësve horizontal, largimi i barojave ku kanë qenë rreth 4 orë punë, si dhe riparimi dhe saldimi i dëmeve në lodrat në park, pajisjet për ushtrime, rrethoja, objekte komunale si dhe ulëse ku janë 50 orë punë, si dhe mirëmbajtja e shëtitoreve përgjatë brigjeve të lumit Llap ku janë bërë fshirje, larje dhe pastrim ku janë bërë 4900m², që në total nga kontrata për mirëmbajtje vlera totale është 114,364.70€.

Duke pasur parasysh të hyrat nga kontrata e mirëmbajtjes së hapësirave të brendshme apo pastrimi i hapësirave të brendshme ku kemi marrëveshje për pastrimin e Emergjencave, Spitaleve, Qendrave Kulturore dhe Ambulantave të Mjekësisë familjare, që është me mujore e që pastrimi i hapësirave të brendshme është 33545m², pastaj 39408m² është për hapësira të jashtme ku përfshihen parqet përreth Emergjencës dhe Ambulancës së Mjekësisë Familjare.

Tek performanca financiare kuptojmë se NPL "Eko-Llapi" ka pasë një buxhet total në vlerë kapitale 30,000.00€.

Të hyrat nga puna të cilat ika kryer kjo Ndërmarrje e kuptojmë se punët të cilat kanë filluar në terren janë prej 01 korrikut e tutje dhe të hyrat e krijuara janë në vlerë 127,000.00€, ndërsa për shpenzime operative janë tërhequr 122,000.00€ ku në kuadër të shpenzimeve kanë hyrë shpenzimet e derivateve, shpenzimet e kontributit të punëtorëve, shpenzimet e mirëmbajtjes, pagat, provizionet si dhe shpenzimet e telefonit, pra kemi një fitim neto për këtë periudhë rreth 4570.00€, mirëpo duke pasë parasysh se ky nuk është një Raport përfundimtarë por është preliminar kuptojmë se përfundimi i këtij Raporti përfshinë deri më 31 mars, në kuadër të kësaj përveç fitimit që ishte 4570.00€ kemi edhe fatura të cilat nuk janë kryer nga kontrata për mirëmbajtjen e

hapësirave të brendshme dhe të jashtme të cilat nuk janë kryer ende dhe janë pa përfunduar por që pritet të përfundojnë deri më 31 mars 2025.

Pra kjo ishte paraqitja e Raportit në fjalë, jam i hapur për çdo pyetje apo sqarim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë raport besoj që materiali ju është përcjellë dhe keni mund ta lexoni dhe analizoni.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e vlerësojmë si pozitiv këtë Raport vjetor të NPL “Eko-Llapi” dhe e falënderojmë Kryeshefin Ekzekutiv për këtë raport kaq të detajuar. Megjithatë kam disa pyetje për parafolësin z.Burim Hasani, tek mirëmbajtja e varrezave, pastaj mirëmbajtja e ndriçimit publik, deratizimi dezinfektimi dhe dezinfektimi i objekteve dhe hapësirave publike, për cilat varreza është duke u bërë fjalë në qytet apo edhe në fshatra, si dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik për cilin territor është duke u bërë fjalë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, po të dëgjohej duke u lexuar nga parafolësi zotëri Hasani ky raport goxha hijshëm por unë mendoj se përveç që ka shumë shkelje këtu ka edhe vepër penale ngase në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Lokale, marrëveshjet me këto Ndërmarrje i nënshkruan jashtë Zyrës së prokurimit Kryeshefi Ekzekutiv me Kryetarin e Komunës, por ato nënshkruhen kur lënda është e përfunduar në prokurim, kurse krejt këto që u përmenden si punë që janë kryer do të thotë ka kontrata për to. Ka kompani që marrin para për këto punë, shembull u përmend mirëmbajtja dimërore dhe verore e që veç sa është dhënë kontrata në shumë 567,492.00€ pra operatori Eing e ka marrë, të gjitha faturat e saj i kam, do të thotë ti i kryen punët ai i merr paratë e që ti si Ndërmarrje nuk ke të drejtë për asnjë punë çka është në kontratë me specifikim teknik nuk guxon ta prekësh, përndryshe çka do që ti kryen punë të cilat i ka në kontratë ai paratë duhet t’i merr sepse ka nënshkruar kontratë me Komunën dhe atë për 18 muaj.

Pastaj i përmendi shumë pika, pastrimi i lumenjve e që edhe aty ka kontratë Komuna me operator ekonomik, madje për krejt pikat që i përmendi kolegu parafolës gjatë raportimit ka kontratë, përveç te autolarja ose larja e veturave që nuk jam i sigurt a ka përfunduar kontrata e nëse ka përfunduar me NPL “Eko-Llapi” është në rregull, tjerat jo. Po ashtu tha mirëmbajtja e gjelbërimit të lartë apo krasitja e drunjtëve, ai tjetri e ka në pikë tek mirëmbajtja dimërore dhe verore, pastaj u përmend mirëmbajtja e trotuareve, e varrezave, unë nuk e di për cilat varreza po bëhet fjalë kur e dim që shumica e fshatrave i paguajnë vet andaj nuk e di ku janë mirëmbajtur ato varreza. Pastaj u përmend edhe pastrimi i fontanave e që shembull edhe për këtë ka kontratë me operator ekonomik i cili e ka marrë kontratën në shumë 8500.00€, pra ti shkon e pastron fontanën kurse paratë i merre dikush tjetër, ose mund të shpërndahen dy herë e që është e kundërligjshme dhe vepër penale ngase në qoftë se ka kontratë të nënshkruar ose duhet të bëjë shkelje ai operator, t’i shkëputet kontrata dhe ai operator nuk e kryen as një punë por në bazë të Ligjit të prokurimit i merre 70% të vlerës së kontratës.

U përmendën edhe shumë pika nga ana e kolegut që e paraqiti këtë Raport siç ishte riparimi dhe saldimi i dëmeve fizike të lojërave, edhe këtu ka pasë kontratë me operator ekonomik, dhe t’ju tregoj drejtë unë nuk besoj se si Ndërmarrje nuk keni as aparat për saldime, as elektroda, as ratifikë për t’i kryer ato punë, ndërsa edhe këtu i’u kishin dhënë 2000.00€ e që dikush tjetër ka pasë për ta kryer këtë punë.

Unë shpresoj që auditimi t’i hyjë kësaj Ndërmarrje dhe këtyre punëve dhe t’iu dënoj që keni kryer punët e huaja, të cilat janë me kontrata me operator.

Punët të cilat Komuna ka në planifikim t’ia jap Ndërmarrjes “Eko-Llapi”, të mos i fut në prokurim fare që t’i marrin kompanitë private, por t’i kryeni vetëm ju si Ndërmarrje dhe të mos i’u përzihet askush, e jo ato të jenë të kontraktuara kurse ju të merrni para dhe ata të marrin para, kjo është shumë shkelje e rëndë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk kemi kuorum sepse prezent në sallë tani janë vetëm 14 anëtar/e të Kuvendit, më tutje nuk mund të vazhdojmë, andaj këtë mbledhje e ndërprej tani, dhe të njëjtën mund të vazhdojmë kur do që krijohen kushtet, për çka sigurisht se ju lajmëroj me kohë.

Konstatim:

Meqë në sallë ishin prezent vetëm 14 anëtar/e të Kuvendit dhe kësaj mungon kuorumi sikurse që gjatë mbledhjes mungonte kohëpaskohshëm, Kryesuesi i Kuvendit ndërprente mbledhjen duke theksuar se vazhdimi i kësaj mbledhje, respektivisht pikave të mbetura të rendit të ditës, do të bëhet kur të krijohen kushtet dhe për këtë do të lajmëroheni me kohë.

Mbledhja ndërpritet në ora 13:25

**Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0006459/25
Podujevë,
29 janar 2025**

**Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha**

Pikat 6 dhe 7 në vijim, mbeten pa u shqyrtuar për shkak të ndërprerjes së mbledhjes për arsye të mungesës së kuorumit.

6. Propozim vendimi për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.A. Podujevë; NPL Stacioni i Autobusëve, NPL për Banim, NPL “Eko-Llapi” (pikë nga mbledhja e kaluar e Kuvendit)

7. Të Ndryshme